



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 22.08.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti APK-DPKI-06-1266/23, për zyrtarin e lartë z. Ilirik Musliu, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Siguri në Komunën e Prishtinës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Ilirik Musliu, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi është identifikuar se z. Ilirik Musliu, krahas ushtrimit të funksionit publik Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Siguri në Komunën e Prishtinës, është edhe përfaqësuese e autorizuar në bizneset private: “GoldBerry” SH.P.K. dhe “IMB Consulting” SH.P.K.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), me shkresën zyrtare DPKI-06-02/1321/23, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, z. Ilirik Musliu është njoftuar lidhur me faktet për rastin e tij, si dhe është udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmerret për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë përfaqësues i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.



Zyrtari e lartë z. Ilirik Musliu, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë dhe ka deklaruar se menjëherë do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e papajtueshmërisë - konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar informatën, të cilën më pas e ka konfirmuar nga ARBK (DPKI-06-02/1321-1/2023), se zyrtari e lartë ka bërë ndryshimet e nevojshme në biznese, duke bartur të drejtat e drejtimit të biznesit tek një person tjetër (personi i besuar).

Pas analizimit të informatave si më lartë, Agjencia konstatoi se zyrtari e lartë z. Ilirik Musliu, ka transferuar të drejtat e drejtimit të biznesit privat tek personi i besuar, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 15 të LPKI-së. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshka
Drejtör i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

